



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "TIC LOG" Sh.P.K. të datës 12.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 033 121, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "TIC LOG" Sh.P.K. e datës 12.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 033 121 ashtu që **ANULOHE**t njoftimi mbi vendimin i datës 07.04.2023 i autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "TIC LOG" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "TIC LOG" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 12.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 033 121.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është cituar si në vijim:

- "OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar kriteret e dosjes së tenderit më saktësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1/9.2 të FDT për arsye se lista e kontratave të OE fitues nuk përmbushë as për së afërmi kërkesat e AK..... Kontrata e listuar në pozicionin 1.0 te lista e kontratave të OE fitues është kontratë me titull 'Furnizim me rekuizita dhe pajisje sportive (Nabavka sportskih rekvizita i opreme) dhe titulli i paraqitur në listë nga OE fitues është i pasaktë dhe kjo mund të vërtetohet fare lehtë duke e krahasuar me kontratën në Eprokurim ... dhe kjo kontratë nuk ka fare ngjashmëri me produktin e kërkuar dhe si e tillë nuk mund të merret si kontratë e ngjashme pasi që artikujt e kontratës shihet qartë se nuk kanë të bëjnë fare me dollapë dhe normalisht kjo kontratë nuk duhet të trajtohet si e ngjashme. Kontrata e listuar në pozicionin nr. 3 te lista e kontratave të OE fitues është kontratë krejtësisht e një natyre tjetër dhe nuk ka gare ngjashmëri me produktin e dollapëve dhe si e tillë nuk mund të llogaritet si e ngjashme... Po ashtu shumica e kontratave të paraqitura në listën e kontratave të OE fitues me klientë privat janë kontrata që nuk kanë fare të bëjnë me dollapë që në brendësinë e tyre bazuar në faturat dhe fletdërgesat shihet qartë se shumica e artikujve nuk kanë ngjashmëri me kërkesat e AK por kryesisht janë furnizim me materiale shpenzuese dhe në disa artikuj ku shkruan dollap apo raftë (janë raftë tavolinash) janë me vlera të vogla që në total nëse i marrim si produkte të ngjashme maximumi mund të arrij vlerën 5,000.00 Euro që është larg vlerës së kërkuar prej 100,000.00Euro".

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 60 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale si në vijim:

- Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit të datës 22.02.2023;
- Oferta e operatorit ekonomik "G.I.Grafo-Loni" Sh.P.K. i rekomanduar për kontratë;
- Raporti i komisionit për vlerësim i datës 05.04.2023;
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontratës i datës 07.04.2023.

Pas njoftimit të datës 27.03.2023 për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 20.04.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimi i parashtruesit është i bazuar në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

Fillimisht duhet cekur ky aktivitet i prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në" bazuar në Dosjen e Tenderit (tutje "DT") përkatësisht aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme ka të bëjë me furnizimin, punimin dhe montimin e dollapëve/lockers metalik në përputhje me specifikat e përcaktuara me DT.

Tutje duhet potencuar që bazuar në Fletën e të Dhënave të Tenderit (tutje "FDT") përkatësisht numri i nenit 9.1&9.2 lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është përcaktuar kriteri sipas të cilit "Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlerë minimale prej 100,000.00 Euro në tri (3) vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë". Ky kriter sipas FDT duhet të dëshmohet përmes "listës së kontratave të realizuara duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimisht dhe datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkangjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve".

Me rastin e analizimit të dokumenteve të ofertës dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar përkatësisht aneksit 6 – Listës së kontratave të realizuara është gjetur se në pozicionin me nr. 1 në tabelë është kontrata me titull "Furnizim me inventar" e nënshkruar me datë 16.12.2020 dhe e përfunduar me datë 15.12.2022 në vlerë 45,855.00 Euro pranë autoritetit kontraktues – Komuna e Graçanicës (shih fig. nr. 1).

Fig. nr. 1 – Lista e kontrave sipas aneks 6 të tenderuesit të rekomanduar, pozicioni nr. 1

N.T.G.I. "GRAFO - LONI" SH.P.K NUI: 810499633, Mob: 044/173-187						
<i>Lista e Kontratave</i>						
Nr.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Vlera totale e kontratës €	Emri i Blerësit-AK	E-maili i Blerësit-AK
1	Furnizim me inventar	16.12.2020	15.12.2022	45,855.00	Komuna e Graçanicës	procurement gracanica@g mail.com

Tutje janë analizuar edhe dokumentet e dorëzuara nga tenderuesi i rekomanduar me datë 28.03.2023 me titull "Referencat 2023 inventar – Grafo-Loni" ku janë bashkangjitur referencat përkatësisht certifikatat dhe faturat për kryerjen e punëve sipas kontratave të listuara në aneksin 6 të DT. Me këtë rast është gjetur se kontrata e lidhur me Komunën e Graçanicës e datës 16.12.2020 deri me datë 15.12.2022 në vlerën 45,855.00 Euro e ka titullin "Nabavka sportskih rekvizita i opreme – Ritender" që në gjuhën shqipe nënkupton "Furnizim me rekuizita dhe pajisje sportive – Ritender". Ky titull nuk përputhet me titullin që është evidentuar në listën e kontratave sipas aneksit 6 të DT nga tenderuesi i tenderit ku kontrata titullohet vetëm si "Furnizim me inventar" (shih fig. nr 2).

Fig. nr. 2 – Referenca për kontratën nr. 1 në listën e kontratave - ankes 6 të tenderuesit të rekomanduar

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosovo		 Komuna e Graçanicës Skupština Opštine Gračanica Municipal Assambly Gračanica	
Drejtoria për Administratë/Direkcija za Administracija /Directory for Administration Kancelarija nabavke			
DATE/DATUM:	31.01.2023.		
REFERENCE/REFERENCA:	054		
PËR/ZA/TO:	EO G.I.Grafo - Loni SH.P.K. – Priština		
CC:	Predsednik Opštine, Ljiljana Šubarić		
NGA/OD/FROM:	Dejan Todorović, Šef nabavke, Opština Gračanica		
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	PREPORUKA		



PREPORUKA

Na osnovu zahteva EO G.I.Grafo - Loni SH.P.K. – Priština sa brojem biznisa 810499633 od 30.01.2023. Opština Gračanica izdaje ovom EO preporuku i potvrđuje da je kompanija **G.I.Grafo - Loni SH.P.K. – Priština** uspešno i kvalitetno ispunjavala sve obaveze preuzete realizacijom ugovora: "Nabavka sportskih rekvizita i opreme – Ritender" sa brojem nabavke, **GRA618-20-7875-1-2-1** u vrednosti od **45.855,00** evra.

Në këtë mënyrë është gjetur se tenderuesi nuk ka cituar titullin e saktë të kontratës në ofertën e tij sikurse është kërkuar me DT. Për më tepër, nga referencat e dorëzuara me datë 28.03.2023 është gjetur se kjo kontratë ka të bëj me furnizim me rekvizita dhe pajisje sportive dhe si e tillë nuk ka asnjë ndërlidhje me furnizimin me dollapa metalik për të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Kjo është në kundërshtim me nenin 9.1&9.2 të DT ku specifikisht kërkohen "kontrata të ngjashme". Kur merret parasysh edhe fakti që tenderuesi i rekomanduar e ka paraqitur një titull komplet ndryshe të kontratës prej titullit të saktë, kjo mund të interpretohet si tendencë që të vihet në lajthitje dhe të mashtrohet autoriteti kontraktues.

Tutje është gjetur se kontrata në pozicionin nr. 3 në listën e kontratave sipas aneksit 6 të ofertës së tenderuesit të rekomanduar është kontrata e evidentuar me titullin "Furnizim me pajisje infografike në objektet e Komunës së Prishtinës" e nënshkruar me datë 07.08.2019 dhe e përfunduar me datës 31.12.2020 me vlerë 99,898.06 Euro pranë autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës. Në dokumentet e dorëzuara me datë 28.03.2023 është paraqitur edhe një referencë lidhur me këtë kontratë si dhe tri (3) fatura me numra dhe vlera të ndryshme. Nga vet titulli i kontratës në pozicionin nr. 3 mund të thuhet se kjo kontratë ka të bëj me pajisje infografike (pajisje për informim grafik) dhe nuk ka asnjë ndërlidhje me furnizimin me dollapa metalik për shkolla për çka është ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar. Prandaj edhe kjo është në kundërshtim me nenin 9.1&9.2 të DT ku specifikisht kërkohen "kontrata të ngjashme" (shih fig. nr. 3).

Fig. nr. 3 – Lista e kontrave sipas aneks 6 të tenderuesit të rekomanduar, pozicioni nr. 3

N.T.G.I. "GRAFO - LONI" SH.P.K NUI: 810499633, Mob: 044/173-187						
<i>Lista e Kontratave</i>						
Nr.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Vlera totale e kontratës €	Emri i Blerësit-AK	E-maili i Blerësit-AK
1	Furnizim me inventar	16.12.2020	15.12.2022	45,855.00	Komuna e Graçanices	procurement.gracanica@gmail.com
2	Furnizim me ormana metalik	29.09.2020	09.10.2020	287,92	KEK. SH.A	Flamur.bekteshi@kek-energy.com
3	Furnizim me pajisje për infografike në objektet e Komunes së Prishtinës	07.08.2019	31.12.2020	99,898.06	Komuna e Prishtinës	Fatinda.Bajrami@rks-gov.net

Gjendja faktike si më sipër nuk është evidentuar askund në raportin e komisionit të vlerësimit të datës 05.04.2023. Pa çka duhet cekur se të gjitha kontratat tjera përveç kontratave në pozicionin nr. 1 dhe nr. 3 nuk kanë as përarsisht vlerën minimale të përgjithshme mbi 100,000.00 Euro sikurse është kërkuar me DT. Në këtë kontekst komisioni duke u bazuar në nenin 7 dhe 59 të LPP duhet të bëjë vlerësimin me kujdes të ofertave për të gjithë tenderuesit pa përjashtim për të përcaktuar nëse kontratat e evidentuara në listat e dorëzuara sipas ankesit 6 të DT i kanë emërtimet e sakta të kontratave, pastaj nëse këto kontrata si të tilla duhet të konsiderohen si "kontrata të ngjashme" për këtë aktivitet siç kërkohet me DT si dhe të shqyrtohet nëse referencat përkatësisht certifikatat apo faturat e dorëzuara lidhur me këto kontrata janë në përputhje me njëra tjetrën dhe e konfirmojnë se kontratat në fjalë janë kontrata të ngjashme sipas DT. Për më tepër komisioni për vlerësim duhet të jetë efikas dhe efektiv në punën e vet duke dëshmuar nivelin e lartë të profesionalizmit ashtu që të identifikoj dhe të evidentoj të gjitha tendencat eventuale të tenderuesve për të vënë në lajthitje apo për të mashtruar autoritetin kontraktues duke paraqitur qëllimisht të dhëna të pasakta në ofertat e tyre.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është konfirmuar se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i bazuar. Kjo pasi që është gjetur se komisioni vlerësues nuk ka marrë në konsideratë nenin 40.2 lidhur me nenin 40.1 të RRPP si dhe lidhur me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.04.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.